



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 1233/14Prot.

Tiranë, më 29.04.2017

V E N D I M

Nr.37, Datë 29.04.2017

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË HIMARË DHE ISH KOMUNAT LUKOVË E HORË - VRANISHT, "MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE" PËR PERIUDHËN 01.07.2014 DERI 31.12.2016.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamenti i Auditimit të Njesive të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare", të ushtruar në Bashkinë Himarë dhe ish-Komunat Lukove, Horë-Vranisht, për periudhën 01.07.2014 deri më 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A.MASA ORGANIZATIVE:

Në mbështetje të shkronjës (a) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të neneve

98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë auditoriale, të nxirren aktet administrative në vlerën prej **261,262,511 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi:

a-Pas kryerje së reformës administrative dhe kalimi i aktivitetit të bizneseve në Bashkinë Himarë, nga punonjësit e ish Komunave, aktualisht Njësi administrative Lukovë dhe Horë-Vranisht,po dhe lëvizjet e shpeshita në Drejtorinë e taksave të Bashkisë Himarë, punonjësit të cilët janë larguar apo janë emëruar të rinj, nuk kanë marrë apo dorëzuar detyrën dhe listat apo dosjet e bizneseve me proces verbal,në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”

b-Nga Drejtori i të Ardhurave nuk është ndarë detyra për secilin punonjës, nuk është bërë një inventar fizik i dosjeve të vetë Bashkisë Himarë. Nga 460 subjekte që ushtrojnë aktivitetin në Bashkinë Himarë më datën 31.12.2016, vetëm për gjysmën ose 230 prej tyre janë hapur dosje por edhe këto jo të plotë, në kundërshtim me nenin 29 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH.” i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Himarë nenet 65-69, - Detyrat e Drejtorisë të Ardhurave dhe specialistëve, Miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 10 date 11.09.2015 dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 38 date 26.02.2016.

1.1 Rekomandimi:

a.Nga ana e punonjësve të ish 2-Komunave, aktualisht Njësi administrative respektivisht: Lukovë dhe Horë-Vranisht,të dorëzohen me proces verbal detyra dhe dokumentacioni përkatës, veçanërisht listat e bizneseve private të cilat nuk kanë paguar taksat vendore për tre vitet 2012 -2013 -2014 deri në shkrirjen e tyre më datën 15.07.2015.

b.Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Himarë të marrë masa për ndarjen e detyrave për secilin punonjës, duke u caktuar numrin e bizneseve sipas NUIS (NIPTEV-e) apo fshatrave për taksën e tokës dhe taksat e popullatës. Dosjet e subjekteve tatimpaguese të plotësohen me inventarët fizikë të përmbajtjes tyre, si Regjistrimi në QKR, njoftim vlerësimit tatimor, njoftim detyrimi, dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi), gen-planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, akt konstatimet apo akt verifikimet për mbylljen e aktivitetit, në bashkëveprim me Policinë Bashkiake, etj, dokumente të përcaktuara në nenin 29 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH.” i ndryshuar.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e Bashkisë Himarë nuk janë plotësuar për secilin subjekt njoftimet e detyrimit tatimor dhe nuk u janë dërguar në rrugë postare subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar taksat dhe tarifatat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues. Veprimi dhe mosveprim në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 70 të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

2.1 Rekomandimi: Nga administrata tatimore e Bashkisë Himarë të meren masa për dërgimin e njoftim vlerësimeve tatimore nëpërmjet postës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë Himarë janë kryer në vite kontabilizimet për debitorët e taksave por duke qenë se nuk është bërë rakordim periodik dhe në fund të secilin vit, me mbylljen e bilancit kontabël, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të ardhurave nuk janë në gjendje të japin listat me emrat dhe NUIS të debitorëve të Taksave të Biznesit, pasi sipas bilancit më datën 31.12.2015 llogaria 468-Debitorë të ndryshëm, paraqitet me gjendje debitorë në vlerën 252,289,996 leke dhe më datën 31.12.2016 paraqitet me gjendje debitorë në vlerën 232,445,033 lekë, ose 19,844,963 leke, më pak. (Bilanc i vitit 2016 në proces mbyllje).

Nga të dhënat që na u paraqitën nga Drejtoria e Buxhetit rezultojnë se në këtë debi janë përfshirë edhe listat e 201 debitorëve në vlerën prej 104.104.761 lekë të nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, respektivisht 164 debitorë për vitin 2012 në vlerën 92,947,029 lekë dhe në vitin 2013 në vlerën 11,157,732 lekë (shifra të cilat nuk janë të argumentuar me listat e subjekteve debitorë). Veprimet apo mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr.9228, dt. 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, ”Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2 shkronja (c),”Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë, të veprohet për të saktësuar dhe rakorduar të dhënat të e pasqyruara në bilancet kontabile, më datën 31.12.2016 (pasqyrat financiare) dhe të dhënat që disponon në formatin elektronik dhe të printuar Drejtoria e të Ardhurave, duke e azhurnuar edhe me subjektet në terren. Të saktësohen debitorët e mbartur nga vitet 2012-2013, të dërgohen njoftim vlerësimet, urdhër bllokimit në bankë, si dhe vendosja e barës siguroese në ZVRPP apo Drejtoria Rajonale e Transportit.

Brenda datës 30.09.2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura rezultojnë se më datën 31.12.2016 nuk kanë paguar taksat vendore në shkallë Bashkie Himarë në vlerën **82,021,086 lekë**, e cila përbëhet nga:

a- 421 biznese debitorë në vlerën 37,288,518 lekë.

b-1194 fermerë debitor për taksën e tokës Njësinë Administrative Lukovë në vlerën 13,481,954 lekë.

c- debitorë për taksën e tokës, taksa e popullatës (ndërtesa,pastrimet) në vlerën 31,250,614 lekë etj, të cilat janë të hedhura në sistemin elektronik Bashkia Himarë, por të pa rakorduar me personat debitorë apo Librezat individuale për secilin person.

4.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nga Drejtoria e të Ardhurave të nxiren njoftim vlerësimet tatimore në vlerën **47,493,380 lekë**. (37,288,518 lekë për 421 biznese dhe 318 persona për 1659 dhoma plazhi në vlerën 10,204,862 lekë)

Për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b-Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”. i ndryshuar.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e kamat vonesave, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë

(gjobë), bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH “ të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014 datë 15.12.2014.

d- Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë Himarë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

e- Drejtoria e të ardhurave në Bashkinë Himarë, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës nga 1194 fermerë (Njësia Administrative Lukovë) për vlerën 13,481,954 lekë, taksa e popullatës dhe tokës (Bashkia Himarë) për vlerën 31,250,614 lekë. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë Himarë dhe 2 njësitë Administrative Lukovë dhe Horë-Vranisht) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifaf etj. (*Listat e debitorëve për Bashkinë Himarë dhe Njësinë Administrative Lukovë gjenden pranë Drejtorisë të Ardhurave Bashkia Himarë, te printuara dhe në mënyrë elektronike (Anekset nr. 1,2 dhe 3)*

Menjëherë

5- Gjetje nga auditimi: Bashkia Himarë për 2 vjetet 2015-2016 nuk ka grumbulluar taksat dhe tarifaf vendore në shumën 90,891,000 lekë. Edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjiellës sh.a, Himarë dhe për vitin 2016 kanë patur përfaqësues në Këshillin Administrativ të krijuar kohët e fundit, në të cilën Ujësjiellësi sh.a. Himarë përcaktohej si agent tatimor, për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Himarë.

5.1 -Rekomandimi: Bashkia Himarë të realizojë lidhjen e një marrëveshje me Ujësjiellës sh.a. Himarë, për taksat dhe tarifaf vendore të popullatës, për t'u përfshirë në faturat ujit të pijshëm, nëpërmjet një marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Bashkiak

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Himarë nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar e kontrollit, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për periudhën 2015-2016. Nuk ka një kuptim të qartë të menaxhimit të riskut, nuk ka strategji të riskut apo identifikim të tij sipas nenit 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk ka të dokumentuar shkresë për bashkëpunimin me menaxherët e tjerë të institucionit për krijimin e regjistrit të riskut, nuk është kryer rivlerësimi dhe matja vjetore e riskut të veprimtarisë së njësisë dhe si pasojë as identifikimi i përgjigjeve ndaj çdo risku. Nuk është ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe nuk janë realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë (Bashkinë Himarë) në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

6.1.Rekomandim Bashkia Himarë, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të ngrihet GMS, të hartohet regjistri i riskut dhe në mënyrë periodike të analizohen dhe

merren masa për risqet që rrezikojnë realizimin objektivave. Të hartohet rregullore për kodin e etikës dhe zbatimin e ligjit për arkivat. Për proceset kryesore të punës të hartohet gjurma e auditimit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Himarë është filluar procesi për marrjen e nismës për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, ku ka marrë vendimin nr.10, datë 02.11.2015, por nuk e ka përfunduar procedurën përfundimtare deri në miratim nga KKT, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për zhvillimin e territorit vendor, të përcaktuar në nenin 20, të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe nenin 3, të VKM nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.

7.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë të marrë masa dhe të përfundojë procesin për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar nga neni 20 i ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.

Në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi:

a) Bashkia Himarë nuk ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi (Bashkia Himarë) dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës.

b) Nga nëpunësi autorizues, (Titullari, Kryetari i Bashkisë) nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia, nuk është mbajtur regjistri i veçantë edhe për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik,

c) Nga ish Komunitat Lukovë dhe Horë-Vranisht se nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim të aseteve, nuk është kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrim, si dhe nuk është kryer inventarizimi i pronave me procesverbale të nënshkruara nga përfituesi i aseteve ish komunave dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, proces-verbale të duhej të ishin shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre.

d) Nga Bashkia Himarë, nuk është hartuar përmbledhja dhe bashkimi i listave të aseteve të Bashkisë Himarë dhe dy njësi administrative, ish-komunitat, Horë-Vranisht dhe Lukovë, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të Bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Himarë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 33-2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të VKM nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë të marrë masa që për asetet që ka në administrim si dhe për asetet e trashëguara nga ish Komunitat në juridiksion të saj, Horë-Vranisht dhe Lukovë, të krijojë një komision për marrjen në dorëzim dhe të hartojnë proces verbale ku të nënshkruhen nga përfituesi dhe dorëzuesi i pronës, të marrë masa për krijimin e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron

apo ka në administrim Bashkia, gjithashtu të krijoj regjistër të veçantë për pasuritë e dhëna me qira ku të evidentohen të dhënat e nevojshme si dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha asetëve në pronësi të saj në ZVRPP.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Himarë nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6, 11 dhe 12, në vlerën 101,574,450 lekë, për 9 raste të cilat përbëjnë efekt financiar negativ, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë nëpërmjet strukturave të saj dhe zyra e administrimit të pyjeve e kullotave, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet e pajisur me leje minerare dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **101,574,450 lekë** të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, të bashkëpunojë me AKBN për të saktësuar volumet e raportuara.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Himarë, nuk është vepruar për të kryer veprimet për paksimin dhe heqjen nga fondi pyjor dhe fondi kullor, të sipërfaqeve pyjore e kullimore në të cilat ushtrohet veprimtaria e shfrytëzimit të aktivitetëve private nga subjektet e pajisura me leje minerare në territorin në administrim të bashkisë. Nga Bashkia nuk është dërguar shkresë në formë kërkesë në Ministrinë e Mjedisit, për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqeve prej 75,9 ha nga fondi pyjor, nuk janë ndjekur procedurat për heqjen dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor, në shkelje të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, nenit 17 pika 6; të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12; të VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11 i ndryshuar.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë nëpërmjet strukturave të saj e sidomos zyra e administrimit të pyjeve e kullotave, të marrë masa për të kërkuar në Ministrinë e Mjedisit, plotësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqeve prej 75,9 ha nga fondi pyjor dhe kullor, për të ndjekur procedurat për heqjen dhe ndryshimin e destinacionit të tyre, në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

a) Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Himarë, nuk është vepruar për të aplikuar gjoba në vlerën e punimeve të kryera pa leje ndërtimi, subjekteve persona fizik dhe juridik, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi dhe të dokumentuara me proces verbale konstatimi, ku vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim shoqërohet me vendimin për dënim me gjobë, në vlerën 58,500,000 lekë, për 119 subjekte, sipas Aneksit 11.1.

b) Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Himarë, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, për arkëtimin e tyre, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, në vlerën 1,000,000 lekë, për 9

raste, sipas Aneksit 11.1. Veprimet dhe mosveprimet janë në shkelje të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 52, pika 1, germa “e”, ligjit 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar”, neni 5 germa “b”, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë, zyra e IMTV, për shkeljet e konstatuara nga kundërvajtësit në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, të marrë masa për vendosjen e gjobave në vlerën 58,500,000 lekë, sipas Aneksit 11.1, si dhe të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore deri për ekzekutimin e gjobave të pa arkëtuara në vlerën 1,000,000 lekë, subjekteve, sipas Aneksit 11.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Bashkia Himarë ka zhdoganuar dy mjete zjarrfikëse, me deklaratat doganore nr.6147, datë 30.04.2014 me detyrim doganor për 191,527 lekë, dhe nr.6148, datë 30.04.2014 me detyrim doganorë 193,172 lekë. Për likuidimin e vlerës 12,000 lekë agjensisë doganore për kryerjen e veprimeve doganore, nuk është paraqitur fatura tatimore nga agjenti doganor që ka kryer veprimet dhe tarifa është disa here me e lartë se hartimi i deklaratës doganore nga agjensitë doganore zyrtare.Mjetet nuk janë bërë hyrje në magazine si dhe nuk kanë dokumentacionin e plotë që nga akti i dhurimit, dokumenti i zhdoganimit, transportit si dhe librezat e mjeteve.

12.1.Rekomandimi: Të bëhen hyrje në magazine dy mjetet zjarrfikëse, të lidhen kontratat e shitblerjes së mjeteve para noterit publik dhe të plotësohet dokumentacioni teknik dhe administrativ i tyre dhe tu jepen në ngarkim me dokumentacion të rregullt punonjësve që i administrojnë sipas ligjeve në fuqi.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditim: Në Bashkinë Himarë, nuk ka përfunduar procesi i depozitimit të dokumentacionit ligjor në lidhje me transferimin e arkivave (dokumenteve) dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-komunat, veprime në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 për “Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekur nga riorganizimi administrativo-territorial”.

13.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, të marrë masa për përfundimin e procesit të depozitimit të dokumentacionit ligjor, mbi transferimin e arkivave dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-komunat.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014, 2015 dhe 2016 struktura e Policisë Bashkiake ka qenë e organizuar në nivel sektori dhe e përbërë nga nëntë punonjës të cilët janë vendosur në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit. Nuk janë marrë masa për kryerjen e kualifikimeve dhe trajnimeve. Policia Bashkiake Himarë, për të gjithë periudhën 2014-2015 -2016 ka vendosur vetëm 50 gjoba, në aktivitetin e kësaj strukture për vitin 2014,2015 dhe 2016 nuk ka bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nuk kanë shlyer taksat vendore nga subjekte në vlerën të konsiderueshme.

14.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë të merren masa për trajnimin e punonjësve të Policisë Bashkiake sipas kërkesave ligjore në fuqi. Në rastet e marrjes së punonjësve të rinj në punë të zbatohet procedura e përzgjedhjes nga komisioni i posaçëm. Nga policia Bashkiake të përgatitet dhe plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për pasqyrimin e veprimtarisë së përditshme të këtij sektori.

15.Gjetje nga auditimi:

a-Nga Bashkia Himarë nuk është kthyer përgjigje për të raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit dërguar me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.770/20 prot., datë 30.01.2015, dhe duhet të raportonte brenda 6 muajve që i takon data 30.07.2015, duke shkelur pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga 35 masa organizative të rekomanduara, janë në proces zbatimi 28 nuk janë zbatuar 7 prej tyre.

b-Nga 21 rekomandimet për shpërblim dëmi në vlerën totale 85,310,048 lekë, janë zbatuar e arkëtuar vlera prej 5,164,093 lekë, ose 6% ndaj totalit, sipas aneksit nr.12.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga verifikim rezultoi se edhe pse janë kryer kontabilizimet dhe janë pasqyruar në bilancet kontabël, nga ana e Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë Juridike, nuk është zbatuar plan veprimi i miratuar nga titullari i Bashkisë, duke mos u kërkuar shpërblimi i dëmit në rrugë gjyqësore dhe veçanërisht rekomandimet për taksat dhe tarifat vendore, duke mos kërkuar bllokimin e llogarive në banka, apo vendosjen e barrës siguroese për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme në ZVRPP, në shkelje të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, nenin 15 shkronja (j) dhe neni 30.

c-Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën 01.01.2012 deri më datën 01.01.2013, nga sasia e gjobave të vendosura për ndërtimet pa leje, pa llogaritur kamatë vonesat nuk kanë filluar procedurat e arkëtimit për **202 kundërvajtës në vlerën 33,090,000 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë.

-Nga Bashkia Himarë, Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, edhe pse gjobat nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga 202 kundërvajtës në vlerën 33,090,000 lekë, për to nuk është kërkuar në Gjykatën Administrative, shndërimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, bazuar në nenin 24 - Shndërimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

15.1.Rekomandimi:

a.Bashkia Himarë, të marrë masa dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore nëpërmjet padive në gjykatë, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.770/20 prot., datë 30.01.2015 dhe rikërkuar me shkresën nr.1015/77 prot., datë 06.04.2016, si dhe të shqyrtohen në Këshillin Bashkiak Himarë, për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH për auditimin e periudhës 2013-2014 dërguar me shkresën nr.770/20 prot., datë 30.01.2015 dhe rikërkimin e masave të pazbatuara dërguar me shkresën e KLSH nr.1015/77 prot., datë 06.04.2016.

Menjëherë

b. Bashkia Himarë, Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152 të “Kodit Procedurës Civile në RSH” të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatën Administrative rivendosjen në afat për 202 vendime me gjobë të vendosura gjatë viteve 2011-2012 në vlerën **33,090,000 lekë**. Njëherazi të marrë masa për kërkimin në Gjykatën Administrative edhe kthimin në tituj ekzekutiv të 202 vendimeve të gjobave në vlerën 33,090,000 lekë, në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Në shumën e kërkuar për pagesë përveç vlerës së gjobës, në zbatim të pikës 3, neni 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, të llogariten dhe shtohet edhe vlera e kamat vonesave në masën 2% të vlerës të gjobës për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë, (ose në shumën 60% kamat vonesë mbi gjobën e vendosur)

c. Për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH për auditimin e periudhës 2013-2014 dërguar me shkresën nr.770/20 prot., datë 30.01.2015 dhe rikërkimin e masave të pazbatuara dërguar me shkresën e KLSH nr.1015/77 prot., datë 06.04.2016, Bashkia Himarë të paraqit një material në Këshillin Bashkiak Himarë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Në mbështetje të shkronjës (a) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të neneve 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë audituar, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për kompensimin dhe shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 76,423,849 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Ura në Rrugën Kondraqa-Qendër-Kallam, Lagja Gjilek, Dhërmi**”, Bashkia Himarë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **402,087 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 250,150 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 151,937 pa tvsh si pasojë e miratimit të zërave të rinj të punimeve me efekte negative për buxhetin e Bashkisë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. Kostaq Minxuri, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

1.1.Rekomandim: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **402,087 lekë pa tvsh** nga OE “XXXXXXXXXX” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 114 prot., datë 17.12.2015 me objekt “Ura në Rrugën Kondraqa-Qendër-Kallam, Lagja Gjilek, Dhërmi”, Bashkia Himarë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rikonstrukcion i Rrugës në Lagjen Kondraqe-Qendër-Kallam, Dhërmi**”, Bashkia Himarë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, **1,630,967 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 160,000 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 1,470,967 lekë pa tvsh si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të

Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. R.M, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

2.1.Rekomandim: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,630,967 lekë pa tvsh** nga OE “**██████████**” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 06.08.2014 me objekt “Rikonstruksion i Rugës në Lagjen Kondraqe-Qendër-Kallam, Dhërmi”, Bashkia Himarë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Shëtitorja e Qeparoit, Loti 2**”, Bashkia Himarë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Himarë **dëm ekonomik në vlerën në 696,700 lekë pa tvsh**.

3.1.Rekomandim: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **696,700 lekë pa tvsh** nga BOE “**██████████**” shpk dhe “**██████████**” shpk, në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me objekt “Shëtitorja e Qeparoit, Loti 2”, Bashkia Himarë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Shëtitorja Buzë Detit Qeparo, Faza II**”, Bashkia Himarë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 10,920,000 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik për punime të pakryera në fakt*. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. R M, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

4.1.Rekomandim: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **10,920,000 lekë pa tvsh** nga OE “**██████████**” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 65 prot., datë 25.08.2015 me objekt “**Shëtitorja Buzë Detit Qeparo, Faza II**”, Bashkia Himarë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nuk është përlllogaritur saktë, taksa e ndikimit në infrastrukturë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, gjatë procedurës së miratimit të lejeve të ndërtimit, **në vlerën 556,480 lekë** në dy raste, në shkelje të ligjit nr.107/2014

“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe 2 dhe vendimin e këshillit të bashkisë nr. 26, datë 11.01.2016 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2016”.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e **vlerës 556,480 lekë**, për taksën e ndikimit në infrastrukturë *si më poshtë*: -**vlera 35,575 lekë** e subjektit “” shpk, vlera **520,905 lekë** e subjektit “” shpk.

Deri më 31.10.2017

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka vepruar për të krahasuar sipërfaqen ndërtimore të përcaktuar në plan vendosjen e objektit, me sipërfaqen e përlllogaritur në faturën për arkëtim, për Lejen e ndërtimit të miratuar me nr.1 prot, datë 28.01.2016, me zhvillues “N” shpk, rezulton diferencë më tepër prej 103,82 m² midis sipërfaqes ndërtimore të përcaktuar në plan vendosje krahasuar me sipërfaqen e përlllogaritur, çka tregon se subjekti ka ndërtuar sipërfaqe ndërtimore më tepër se sa ka miratuar në plan vendosje dhe në lejen e zhvillimore dhe lejen e ndërtimit, subjekti dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje **3,375,811 lekë**, në shkelje të ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 52, pika 1 germa “ë”/ ii.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mrojtjes së Territorit të Bashkisë, të marrë masa për vendosjen e gjobës dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e **vlerës 3,375,811 lekë**, për vlerën e punimeve të kryera pa leje nga subjekti “” shpk.

Deri më 31.10.2017

7. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk janë përlllogaritur saktë, detyrimet për tarifën vjetore të ndriçimit, gjelbërimit dhe shërbimeve të tjera, që kanë subjektet e ndërtimit që janë pajisur me leje ndërtimi në pronë private dhe shtetërore si dhe me Certifikatat e përdorimit të objekteve në pronë private, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe vendimeve të këshillit të bashkisë nr. 165, datë 24.01.2014, për paketën fiskale të vitit 2014, vendimin e këshillit të bashkisë nr. 194, datë 03.12.2014, për paketën fiskale të vitit 2015, vendimin e këshillit të bashkisë nr. 26, datë 11.01.2016 për paketën fiskale të vitit 2016, **në vlerën 681,000 lekë, në 19 raste.**

7.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e **vlerës 681,000 lekë, nga 19 subjekte**, sipas Aneksit 8.1. për detyrimet për tarifën vjetore të ndriçimit, gjelbërimit dhe shërbimeve të tjera.

Deri më 31.10.2017

8. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk janë përlllogaritur saktë, detyrimet për tarifën vjetore të pastrimit urban, që kanë subjektet e ndërtimit, për vendndodhjen kryesore dhe filiale, që janë pajisur me leje ndërtimi në pronë private dhe shtetërore si dhe me Certifikatat e përdorimit të objekteve në pronë private, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe vendimeve të këshillit të bashkisë nr. 165, datë 24.01.2014, për paketën fiskale të vitit 2014, vendimin e këshillit të bashkisë nr. 194, datë 03.12.2014, për paketën fiskale të vitit 2015, vendimin e këshillit të bashkisë nr. 26, datë 11.01.2016 për paketën fiskale të vitit 2016, **në vlerën 1,700,000 lekë, në 19 raste**, sipas Aneksit 8.1. bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për

arkëtim e vlerës **1,700,000 lekë**, nga 19 subjekte, sipas Aneksit 8.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për detyrimet për tarifën vjetore të pastrimit urban.

Deri më 31.10.2017

9. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka vepruar për të krahasuar vlerën e punimeve të kryera në fakt në objekt të cilësuar në Aktin e kolaudimit të objektit, krahasuar me vlerën e punimeve të preventivit mbi të cilën është përlogaritur taksa e ndikimit në Infrastrukturë, gjatë procedurës së miratimit të lejeve të shfrytëzimit për Çertifikatën e përdorimit, nr.1750 prot, datë 10.09.2015, për objektin “ 2 godina 4 kate dhe një kat bodrum”, me zhvillues “S” shpk, **në vlerën 421,988 lekë**, në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 13.

9.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e vlerës **421,988 lekë**, nga subjekti “██████████” shpk, detyrim për taksën e ndikimit në Infrastrukturë.

Deri më 31.10.2017

10. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk është vepruar për të krahasuar sipërfaqes ndërtimore të objektit sipas lejes së ndërtimit, me sipërfaqen ndërtimore të aktit të kolaudimit në momentin e miratimit të lejes së shfrytëzimit të objektit për Çertifikata e përdorimit, nr.1259 prot, datë 17.06.2015, për objektin “Banesë 6 kate”, për të cilën rezultoi me diferencë më tepër, shtesë sipërfaqe ndërtimore prej 300 m² e cila i përket sipërfaqes së katit atik e cilësuar në aktin e kolaudimit, si punim i kryer në fakt por i pa miratuar në lejen e ndërtimit, çka tregon se subjekti ka ndërtuar sipërfaqe ndërtimore më tepër se sa ka miratuar në plan vendosje dhe në lejen e zhvillimore dhe lejen e ndërtimit, pra subjekti ka kryer punime në shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit. me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe ndërtimore dhe vëllim ndërtimor, vlera e punimeve për sipërfaqen ndërtimore shtesë prej **8,251,200 lekë**, vlerë e cila është më e madhe se 500,000 lekë, në këtë rast meqenëse vlera e punimeve është më e madhe se vlera e gjobës, **vlera prej 8,251,200 lekë**, në shkelje të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 52, pika 1 germa “ë”ii.

10.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë, të marrë masa për vendosjen e gjobës dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e vlerës **8,251,200 lekë**, nga subjekti “██████████” shpk, detyrim gjobë në masën e vlerës së punimeve për sipërfaqen ndërtimore shtesë.

Deri më 31.10.2017

11.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Himarë, nuk është aplikuar saktë tarifa e vlerës së qirasë lek/ha/vit, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Himarë dhe Kompanive të telefonisë celulare, **në vlerën 9,572,334 lekë**, për 4 subjekte, sipas Aneksit nr.9.1, në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja 2, pika 7, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e vlerës **9,572,334 lekë**, nga 4 subjekte, sipas Aneksit 9.1, për detyrimet për sipas kontratave të qirasë së antenave të telefonisë celulare.

Deri më 31.10.2017

12. Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Himarë ish komuna Lukovë dhe subjekteve private, për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, **në vlerën 466,200 lekë**, për 12 subjekte, sipas Aneksit 9.2, në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja 2, pika 7, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e **vlerës 466,200 lekë**, nga 12 subjekte, sipas Aneksit 9.2, për detyrimet për sipas kontratave të qirasë të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore.

Deri më 31.10.2017

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mëparshëm i KLSH ka rezultuar se në Bashkinë Himarë pa llogaritur Njësinë Administrative Lukovë, nga 318 persona disponohen 1659 dhoma plazhi për të cilat për vitin 2015 dhe 2016 personat që i disponojnë dhomat e plazhit nuk kanë paguar vlerën taksës së fjetjes në hotel, duke krijuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë në shumën **10,204,862 lekë**. (respektivisht për vitin 2014 sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 06, dt. 10.08.2015 me 3,750 lekë/dhomë/vit nr. i dhomave 1659 x 3750 = 6,223,262 lekë.

Për vitin 2016 me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 10.01.2016 taksa e fjetjes në dhomat e plazhit është ulur me 1350 lekë, ose nga 3,750 lekë, në vlerën 2,400 lekë/dhoma/vit ose 1659 dhoma x 2,400 lekë/dhomë/vit = 3,981,600 lekë (Aneksi nr. 3, bashkëlidhur).

13.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të vlerësojë konstatimet dhe gjetjet e KLSH, për të siguruar mbledhjen e të ardhurave të munguara, të vlerësuara sipas aneksit nr. 3, bashkëlidhur.

Deri më 31.10.2017

14. Gjetje nga auditimi: Pas rekomandimit të KLSH në Projektraportin e auditimit, nga ana e z. Ibrahim Dafa ish-inspektor i taksave ish-Komuna Lukovë u dorëzuan listat e 11 subjekteve debitore të pa likuiduara për vitet 2012-2013 të cilat nuk janë të pasqyruara në Bilancin kontabël më datën 31.12.2016 dhe nuk figurojnë as në listat e debitorëve, duke krijuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë (**dëm ekonomik**) në vlerën **464,250 lekë**.

14.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nga Drejtoria e të Ardhurave të nxiren njoftim vlerësimit tatimore për 11 subjekte për detyrimet e pa likuiduara nga vitet 2012-2013 në Njësinë Administrative Lukovë në vlerën **464,250 lekë** (Aneksi nr. 4 bashkëlidhur).

Menjëherë.

15. Gjetje nga auditimi:

a- Në Bashkinë Himarë rezulton se në listë pagesat mbi shpërblimin e këshilltarëve të këshillit bashkiak, këshilltarët janë paguar edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje për periudhën objekt kontrolli, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar. Këshilltarëve ju është dhënë shpërblimi për periudhën korrik 2014 - 30.06.2015, në vlerën **1,300,725 lekë** për ish 32 këshilltarë të Këshillit të Bashkisë shumë e cila përbën dem ekonomik e cila duhet të arkëtohet nga Bashkia Himarë .

b- Nga auditimi i listë pagesave të këshilltarëve të Këshillit të Bashkisë dhe listëpagesat për kryepleqtë konstatohet se A.B. S.K. janë shpërblyer si antarë këshilli dhe si kryeplak njëkohsisht, në kundërshtim me Rregulloren e brendëshme të këshillit të Bashkisë Himarë Neni 47 Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit”. Në Këshillin e Bashkisë Himarë kryetari i Këshillit z.S K është paguar edhe si kryeplak fshati për periudhën 6/mujori i dytë i vitit 2014 deri me 30.06.2015 në vlerën **85,860** lekë më tepër, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionin e Qeverisjes Vendore”, ndërsa antari i Këshillit z.A B është paguar edhe si kryeplak fshati për periudhën 6/mujori i dytë i vitit 2014 deri me 30.06.2015 pra 11 muaj në vlerën **78,705** lekë më tepër, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionin e Qeverisjes Vendore”.

c- Në ish Komunën Horë- Vranisht rezulton se në listë pagesat mbi shpërblimin e këshilltarëve të këshillit të komunës, këshilltarët janë paguar edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje për periudhën objekt kontrolli, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, për periudhën 01.01.2013- 30.06.2015, në vlerën **595,980** lekë për 12 ish këshilltarë të ish Komunës Vranisht, shpërblime në kundërshtim me ligjin dhe që përbejnë dem ekonomik e cila duhet të arkëtohet nga Bashkia Himarë.

d- Në ish Komunën Lukovë, rezulton se në listë pagesat mbi shpërblimin e këshilltarëve të këshillit të komunës, këshilltarët janë paguar edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje për periudhën objekt kontrolli, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, për periudhën 01.01.2013- 30.06.2015, në vlerën **1,351,350** lekë për ish 17 ish këshilltarë të ish Komunës Lukovë, këto shpërblime në kundërshtim me ligjin e sipërcituar përbejnë dem ekonomik e cila duhet të arkëtohet nga Bashkia Himarë.

e- Nga auditimi i listëpagesave të ish antarëve të Këshillit të Komunës Lukovë, u konstatua se Kryetari i Këshillit të Komunës Lukovë z.T G është paguar edhe si kryeplak fshati për periudhën 01.01.2013 - 30.06.2015 pra 30 muaj në vlerën **214,650** lekë më tepër, shumë e cila përbën dem ekonomik, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionin e Qeverisjes Vendore”. Rregullore së brendshme të ish Këshillit Komunës Lukovë “Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit”.

15.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,465,290** lekë, për ish anëtarët e këshillit Bashkiak Himarë, sipas tabelës.

15.2 Rekomandimi: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **595,980** lekë, nga ish anëtarët e këshillit të Komunës Horë Vranisht, sipas tabelës.

15.3 Rekomandimi: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,572,930** lekë për 18 ish këshilltarë të ish Komunës Lukovë, sipas tabelës.

Menjëherë.

16. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Himarë, nga auditimi i dokumentacionit te bankës, rezultuan mangësi në zbatimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me aktet ligjore e

nënligjore të prokurimit publik, UMF nr.30/2011, e konkretisht shpenzimet e kryera me urdhër shpenzimet:

- nr.250, datë 29.12.2014, në shumën **390,000 lekë** “ riparimi dhe blerja e pjeseve të këmbimit për automjetin AA226 AD” me rast emergjencë, nuk ka të përcaktuar vleren e fondit limit për të blerë pjesë këmbimi për riparimin e automjetit, nuk ka fletë hyrjen dhe emrin e personit që e ka marrë në dorzim, nuk disponohet urdhër i Titullarit, shumë e cila përbën dëm ekonomik.

- nr.161, datë 31.08.2015 është kryer pagesa në vlerën **185,800 lekë** për riparimin dhe blerjen e pjeseve të këmbimit për automjetin me targa AA226 AD. Procesverbali i defektit të automjetit me targë AA226 AD është mbajtur duke mos përcaktuar arsyen e defektit dhe pjesë e demtuara, nuk ka fletë hyrje në magazinë të pjesëve të këmbimit të blera dhe personit që e ka marrë në dorzim, nuk disponohet urdhër i Titullarit.

- nr.246, datë 3.12.2015 është kryer pagesa për riparimin dhe blerjen e pjeseve të këmbimit për automjetin AA 972 DL në vlerën **96,000 lekë** me procesverbalin me emergjencë. Procesverbalit i Rasteve Emergjences nuk ka të përcaktuar pjesët që janë demtuar dhe duhen ndërruar, nuk ka arësytim për trajtimin si rast të emergjences, pjesët e këmbimit nuk janë bërë hyrje në magazinë.

- nr.227, datë 03.12.2015 është kryer pagesa për riparimin dhe blerjen e pjeseve të këmbimit sipas Urdhër prokurimi nr.5, datë 29.05.2015, në vlerën **180,000 lekë** në ish Komunën Lukovë, Urdhëri i Prokurimit me vlerë të fondit limit 250,000 lekë është në kundërshtim me Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën prokurimeve me vlerë të vogël” pasi ka tejkaluar kufirin e vlerës prej 100,000 lekësh të përcaktuar sipas pikës 7 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën prokurimeve me vlerë të vogël”. Baza ligjore VKM nr.1, datë 2007 e cilesuar në urdhër prokurimi dhe në procesverbal të vlersimit ofertave është shfuqizuar. Faturat e thjeshta tatimore nr. 57, 58, 59, 60 janë pa datë, dhe janë firmosur nga komisioni i marrjes në dorzim por pa shënuar emërin mbiemrin e blerësit. Mallrat nuk janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë, në kundërshtim me ligjin 10296 dhe udhëzimin nr.30/2011. Fatura e blerjes së pjesëve të këmbimit nuk është nënshkruar nga komisioni i prokurimit si dhe nuk është marrë në dorzim nga komisioni i marrjes në dorzim, duke shkelur pikën 7, paragrafi i dytë i Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën prokurimeve me vlerë të vogël”.

- nr.145, datë 13.06.2016, është kryer pagesa për riparimin dhe blerjen e pjeseve të këmbimit në vlerën **87,000 lekë** të një automjeti pa targë, pa arsye të justifikuar dhe pa u mbështetur në LPP. Pjesët e këmbimit të blera sipas faturës së thjeshtë tatimore nr.11, datë 18.03.2016 në vlerën 87,000 lekë nuk janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë, nuk është nënshkruar nga blersi i mallit, përfaqësuesi i Bashkisë Himarë, nuk janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë si material rikupero me vlerë perdorimi. Për të gjitha këto shkelje të konstatuara vlera e shpenzuar për blerjen e pjesëve këmbimit në vlerën **87,000 lekë** përbën dëm ekonomik.

- nr.269, datë 16.12.2015 është kryer pagesa për blerje karburanti në vlerën 299,896 lekë sipas faturës tatimore nr.30, datë 01.12.2015. Bashkëngjitur këtij urdhër–shpenzimi nuk janë dokumentet urdhërues dhe vertetues pa të cilët nuk duhej të kryhej pagesa sipas kërkesave të UMF nr.30/2011. Në cilësinë e blerësit (tërheqësi i 1,300 litave gaseoil dhe 700 litra benzinë) janë marrë në dorzim nga Drejtori i Planifikimit Urban. Kjo sasi karburanti nuk është bërë hyrje në magazine nga tërheqësi i mallit. Në këto kushte, ky nepunës ka shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **299,896 lekë**, të cilën duhet ta arkëtojë në arkën e Bashkisë Himarë.

- nr.147, datë 19.11.2014, në shumën **81,240 lekë**, është kryer likuidimi për blerjen e materialeve të pastrimit e dizefektimi me faturën tatimore nr.6, datë 20.10.2014. Bashkëngjitur këtij urdhër shpenzimi nuk është fletëhyrja e mallit, në kundërshtim me pikën 37 e 39 të Udhëzimit nr.30/2011.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave:

- **390,000 lekë** shumë e cila përbën dëm ekonomik, nga J.G. personi që ka hartuar procesverbalin e difektit të automjetit AA226AD, dhe që ka terhequr pjesët e këmbimit pa i bërë hyrje në magazine e Bashkisë .
- **185,800 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik, nga J.G. personi që ka hartuar procesverbalin e difektit të automjetit AA226AD, dhe që ka terhequr pjesët e këmbimit pa i bërë hyrje në magazine e Bashkisë dhe A.B. në cilësinë e hartuesit të procesverbalit të defekteve.
- **96,000 lekë** shumë e cila përbën dëm ekonomik, i cili duhet të likuidohet në mënyrë të barabartë nga E Z e komisioni i prokurimit i për blerjen e pjesëve të mjetit me targa AA972 DL, i përbërë nga B.B. E.R. B.R. pasi nuk ka gjurmë personi që i ka marrë në dorzim
- **180,000 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik të ndarë në mënyrë të barabartë nga personat përgjegjës komisioni i prokurimit i për blerjen e pjesëve B.B. E.R. B.R. për riparimin dhe blerjen e pjesëve të këmbimit në ish Komunës Lukovë.
- **87,000 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik në mënyrë të barabartë nga shoferët A.Ll. dhe S.K. anëtarët e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla që kanë terhequr pjesët e këmbimit dhe që nuk i ka bërë hyrje në magazine e Bashkisë A.B. E.R. B.R.
- **299,896 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik për mosargumentin të përdorimit të karburantit, nga G.S.
- **81,240 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik, nga komisioni i prokurimeve me vlera të vogëla i përbërë nga N.D. kryetare, N.H. dhe A.L.

Menjëherë.

17. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimet nr.112, datë 03.07.2015, është kryer likuidimi vullnetar i Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Vlorë (lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit) nr.729, datë 15.04.2015 për vlerë 825,522 lekë, Gjykata ka vendosur si detyrimin ndaj Bashkisë Himarë, që ti kthejë paditësit N.G. shumën 736,438 lekë (aplikim për leje ndertimi është paguar shuma 576,580 lekë për arsye të konflikteve të pronësisë nga Bashkia nuk është zbardhur leja e ndërtimit, subjekti i kërkon gjykatës ti kthehet shuma e paguar në Bashki. Gjykata ka vendosur kthimin e shumës së paguar si dhe të paguaj shpenzimet gjyqësore në vlerën 24,000 lekë, dhe interest në vlerën 248,942 lekë). Për vleften prej 248,942 lekë paguar nga Bashkia Himarë. Së pari: Kjo është përgjegjësi e ish Juristit për çështjet gjyqësore V.L. që nuk ka ndjekur çështjen sipas legjislacionit në fuqi në gjykatë. Së dyti: Leja e Ndertimit nuk ka pasur fuqi Ligjore pas një viti, në këto kushte vërtetohet se nuk ka pasur përgjegjësi Bashkia Himarë.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **272,942 lekë**, nga V.L. (detyrimin që ka vendosur Gjykata në vlerën prej 736,438 lekë ndaj Bashkisë Himarë, që ti kthejë paditësit N.G.shumën 736,438 lekë), shumë e cila për Bashkinë Himarë përbën dëm ekonomik.

Menjëherë.

18. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “**Shëtitorja Qeparo Faza II**”, të zhvilluar me urdhër prokurimi nr. 13, datë 23.06.2015 dhe me fond limit 158.333.348 lekë, KVO ka s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët dhe ka kualifikuar OE me vlerë më të lartë, në kushtet kur ky i fundit nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, duke përdorur dy standarte në klasifikimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa

a, b dhe c, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë, **me pasojë dëmin ekonomik në diferencën e dy ofertave në shumën 4.882.507 lekë.**

18.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **4.882.507 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **1,627,502 lekë**, nga E.M. me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- vlera **1,627,502 lekë**, nga A.B. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- vlera **1,627,502 lekë**, nga S.K. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt **“Rehabilitimi i kalldrëmeve dhe fasadash fshati Kudhës”**, të zhvilluar me urdhër prokurimi nr. 23, datë 11.11.2015 dhe me fond limit 48.750.000 lekë, KVO ka s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët dhe ka kualifikuar OE me vlerë më të lartë, në kushtet kur ky i fundit nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, duke përdorur dy standarte në klasifikimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë, **me pasojë dëmin ekonomik në diferencën e dy ofertave në shumën 15.481 lekë.**

19.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **15,481 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **5.160 lekë**, nga A.B. me detyrë kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- vlera **5.160 lekë**, nga F.B. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- vlera **5.160 lekë**, nga Th.S. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt **“Rrjeti i jashtëm i ujësjellësit me vetëderdhje i fshatit Palase dhe i komplekseve turistike”** me fond limit 24.495.439 lekë, zhvilluar në vitin 2014, u konstatua se: Vendosija e gabuar e kriterëve të veçanta për kualifikim nga ana e NJHDT **kanë shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender duke ndikuar që KVO të skualifikojë padrejtësisht operator ekonomik me vlerë më të ulët**, konkretisht: Është skualifikuar OE “” shpk me vlerë të ofertës 16,710,297 lekë pasi nuk ka paraqitur **“vërtetim të shlyerjes së detyrimeve në Bashkinë Himarë”**. Kërkesë e cila është në kundërshtim me ligjin nr.9643, “Për prokurimin publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 pika 1 pasi paraqitja e këtij vërtetimi është e panevojshme dhe pengesë për ofertuesit pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi sepse Autoriteti Kontraktor ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me debitorët e tij, si edhe prishje e fshehtësisë së procesit. Si pasojë, i është shkaktuar buxhetit të shtetit një **dëm ekonomik në vlerën 6,066,196 lekë.** Veç kësaj, është vepruar me dy standarte pasi është kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues OE “” shpk, me vlerë më të lartë, dhe me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, gërma a, b dhe c dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”, neni 46 pikat (1) dhe (3), dhe me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, pika 2.

20.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **6,066,196 lekë** nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT) e përbërë nga O.G. me detyrë përgjegjës i zyrës pyje kullota, Th.S. me detyrë përgjegjës i Zyrës Juridike dhe K.K. me detyrë inspektor në drejtorin e taksave dhe tarifave vendore, me nga **2,022,065 lekë secili** si pasojë e vendosjes së

kritereve diskriminuese çka kanë ndikuar në s'kualifikim e padrejtë të operatorit ekonomik me vlerë më të ulët "██████████" shpk.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt *"Ura në rrugën Kondraqe-Qendër-Kallam-Lagja Gjilekë-Dhërmi"*, me fond limit 39.697.765 lekë, zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO ka skualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e BOE, me vlerë më të ulët, për mangësi të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla, për asye se nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nuk kanë lidhje me objektin e kontratës së prokuruar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **2,568,348 lekë dëm ekonomik**. Veç kësaj, KVO ka vepruar me dy standarte pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE me vlerë më të lartë, dhe me mangësi në plotësimin DST, të cilat konsiderohen të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", gërma a, b dhe c dhe nenin 20, "Mosdiskriminimi", (Trajtuar në faqet 48 -149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **2,568,348 lekë** nga KVO e përbërë nga F.B. me detyrë specialist i lartë ndërtimi, I.LI. me detyrë kontabiliste për të ardhurat e shpenzimet dhe Th.S. me detyrë përgjegjës i Zyrës Juridik me nga **856,116 lekë secili** për kualifikimin dhe shpalljen e padrejtë fitues të OE "██████████" shpk me vlerë më të lartë.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt *"Rehabilitimi sheshit të fshatit Kudhes"*, me fond limit 8,570,325 lekë, zhvilluar në vitin 2014, u konstatua se: KVO ka vepruar me **dy standarte** në vlerësimin e ofertave, pasi të 3 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë "██████████" shpk me vlerë të ofertës 6,759,533 lekë, "██████████" me vlerë të ofertës 7,579,729 lekë, dhe BOE "██████████" shpk me vlerë të ofertës 8,333,333 lekë, kanë mangësi në plotësimin e "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit", për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë, pasi KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE me vlerë më të lartë të ofertës dhe me dokumentacion të rremë, duke krijuar **dëmin ekonomik në vlerën 1,235,824 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", gërma a, b dhe c dhe nenin 20, "Mosdiskriminimi".

22.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,235,824 lekë** nga KVO e përbërë nga G.S. me detyrë drejtori i planifikimit dhe zhvillimit territorit, K.K. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe A.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, me nga **411,941 lekë secili** për kualifikimin dhe shpalljen e padrejtë fitues të BOE "██████████" me vlerë më të lartë.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt *"Rikonstruksion, sistemim i fasadave dhe nderhyrje rehabilituese të fshatit Kudhes"*, me fond limit 10.000.000 lekë, zhvilluar në vitin 2014, u konstatua se: KVO ka s'kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e BOE "██████████", me vlerë më të ulët, (për mos paraqitje të Certifikatave ISO OHSAS 18001-2007 dhe ISO 14001-2004). Mangësi të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijim i vogël, për asye se nuk prek dhe nuk ndikon në përmasat dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi, në kundërshtim me LPP, nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **1,522,052 lekë dëm ekonomik**. Veç kësaj, KVO

ka vepruar me dy standarte pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE “██████” shpk, me vlerë më të lartë, me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST dhe duke paraqitur dokumentacion të rremë, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, gërma a, b dhe c dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”.

23.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,522,052 lekë** nga KVO e përbërë nga A.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, S.K. me detyrë specialist ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve dhe M.L. me detyrë ish-përgjegjëse financës, me nga **507,350 lekë secili** për kualifikimin dhe shpalljen e padrejtë fitues të OE “██████” shpk me vlerë më të lartë.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Rikonstrukcion i rrugës te derdhja e proit për në port*”, me fond limit 1.080.943 lekë, zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO ka vepruar me **dy standarte** në vlerësimin e ofertave, pasi të 2 OE pjesmarrës në garë konkretisht: OE “██████” shpk me vlerë të ofertës 899,706 lekë, dhe OE “██████” shpk me vlerë të ofertës 1,080,005 lekë dhe duke paraqitur dokumentacion të rremë, kanë mangësi në plotësimin e “Kritëreve të Veçanta të Kualifikimit”, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë, pasi KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “██████” shpk me vlerë më të lartë të ofertës duke krijuar **dëmin ekonomik në vlerën 180,299 lekë**, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, gërma a, b dhe c dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”.

24.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **180,299 lekë** nga KVO e përbërë nga E.M. me detyrë specialist i topografisë, F.B. me detyrë specialist i lartë ndërtimi dhe F.D. me detyrë specialist finance, me nga **60,099 lekë secili** për kualifikimin dhe shpalljen e padrejtë fitues të OE “██████” shpk me vlerë më të lartë.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukove*”, me fond limit 2.237.523 lekë, zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO ka vepruar me **dy standarte** në vlerësimin e ofertave, pasi të 2 OE pjesmarrës në garë BOE “██████” me vlerë të ofertës 1,681,197 lekë dhe OE “██████” shpk me vlerë të ofertës 2,232,864 lekë, kanë mangësi në plotësimin e “Kritëreve të Veçanta të Kualifikimit”, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë, pasi KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “██████” shpk me vlerë më të lartë dhe duke paraqitur dokumentacion të rremë, çka ka krijuar **dëmin ekonomik në vlerën 551,667 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, gërma a, b dhe c dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”.

25.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **551,667 lekë** nga KVO e përbërë nga E.M. me detyrë specialist i topografisë, F.B. me detyrë specialist i lartë ndërtimi dhe S.K. me detyrë specialist ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve, me nga **183,889 lekë secili** për kualifikimin dhe shpalljen e padrejtë fitues të OE “██████” shpk me vlerë më të lartë.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Rikonstrukcion i kanalit Ujitës Vranisht-Terbac*”, me fond limit 23,666,666 milion lekë” zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka mbajtur **qëndrim me dy standarte**, pasi ka s’kualifikuar ofertën e “██████” shpk, me vlerë më të vogël për arsye se nuk ka paraqitur Certifikatë ISO 3834-2006 “*për menaxhimin e cilësisë në*

proceset e punimeve të saldimit". Certifikatë të cilën nuk e ka paraqitur edhe antari i BOE shpallur fitues "██████" shpk, me vlerë më të lartë dhe me mangësi të tjera në plotësimin e kriterëve të DST, çka nuk është konstatuar nga KVO duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **4,830,518 lekë dëm ekonomik**.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", gërma a, b dhe c, nenin 20, "Mosdiskriminimi", dhe me pikën (4), të nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave".

26.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **4.830.518 lekë** nga KVO e përbërë nga I.Ll. me detyrë kontabiliste, F.B. me detyrë specialist i lartë ndërtimi, A.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, me nga **1,610,172 lekë secili** për kualifikimin dhe shpalljen e padrejtë fitues të BOE "██████" me vlerë më të lartë.

Menjëherë

B/1. SHPENZIME NË FUSHËN E PROKURIMEVE, ME IMPAKT NEGATIV NË BUXHET:

Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në bashkinë Himarë, u konstatua se 10 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2, "Parimet e përzgjedhjes", nenin 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", nenin 24, "Anulimi i një procedure prokurimi" dhe pika 5 e nenit 53, "Shqyrtimi i ofertave", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në **vlerën 341,294,207 lekë, duke favorizuar operatorët ekonomikë, në shumën 21,852,892 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike, në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriterë të paplota e konkretisht:**

1. Në tenderin me objekt "**Shëtitorja Qeparo Faza II**", të zhvilluar me urdhër prokurimi nr. 13, datë 23.06.2015 dhe me fond limit 158,333,348 lekë, të zhvilluar më datë 15.06.2015, në të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik "Besta" shpk, me vlerë të ofertës 154,881,896 lekë pa tvsh.

2. Në tenderin me objekt "**Rehabilitimi i kalldrëmeve dhe fasadash fshati Kudhës**", të zhvilluar me urdhër prokurimi nr. 23, datë 11.11.2015 dhe me fond limit 48,750,000 lekë, të zhvilluar më datë 03.12.2015, në të cilin është shpallur fitues operatori ekonomik "██████" shpk, me vlerë të ofertës 48,699,999 lekë pa tvsh.

3. Në tenderin me objekt "**Rrjeti i jashtëm i ujësjellësit me vetëderdhje i fshatit Palase dhe i komplekseve turistike**" me fond limit 24,495,439 lekë, zhvilluar më datë 12.12.2014, në të cilin është shpallur fitues operatori ekonomik "██████" shpk, me vlerë të ofertës 22,776,493 lekë pa tvsh.

4. Në tenderin me objekt "**Rehabilitimi sheshit të fshatit Kudhes**", me fond limit 8570325 lekë, zhvilluar më datë 23.06.2014, në të cilën është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomik "██████", me vlerë të ofertës 8,333,333 lekë pa tvsh.

5. Në tenderin me objekt "**Rikonstruksion, sistemim i fasadave dhe nderhyrje rehabilituese të fshatit Kudhes**", me fond limit 10000000 lekë, zhvilluar me datë 31.10.2014, në të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik "██████" shpk, me vlerë të ofertës 9,999,999 lekë pa tvsh.

6. Në tenderin me objekt **“Rikonstruksion i rrugës te derdhja e proit për në port”**, me fond limit 1,080,943 lekë, zhvilluar më datë 28.05.2015, në të cilin është shpallur fitues OE “████████” shpk, me vlerë të ofertës 1,080,005 lekë pa tvsh.

7. Në tenderin me objekt **“Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukove”**, me fond limit 2237523 lekë, zhvilluar më datë 07.09.2015, në të cilin është shpallur fitues operatori ekonomik “████████” shpk, me vlerë të ofertës 2,232,864 lekë pa tvsh.

8. Në tenderin me objekt **“Rehabilitim i qendrës së fshatit Borsh”**, me fond limit 22.056.096 lekë, të zhvilluar më datë 15.08.2016, në të cilin është shpallur fitues operatori ekonomik “████████” shpk, me vlerë të ofertës 21.777.777 lekë pa tvsh.

9. Në tenderin me objekt **“Rehabilitim urban i sheshit të Lukovës”**, me fond limit 74,551,621 lekë, të zhvilluar më datë 17.08.2016, në të cilin është shpallur fitues operatori ekonomik “████████” shpk, me vlerë të ofertës 69,999,999 lekë pa tvsh.

10. Në tenderin me objekt **“Rikonstruksion i kanalit Ujitës Vranisht-Terbac”**, me fond limit 23,666,666 milion lekë” zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka mbajtur **qëndrim me dy standarte**, pasi ka s’kualifikuar ofertën e “████████” shpk, me vlerë më të vogël për arsye se nuk ka paraqitur Certifikatë ISO 3834-2006 *“për menaxhimin e cilësisë në proceset e punimeve të saldimi”*. Certifikatë të cilën nuk e ka paraqitur edhe antari i BOE shpallur fitues “Shkelqimi 07” shpk, me vlerë më të lartë dhe me mangësi të tjera ne plotësimin e kriterëve të DST.

1.1. Rekomandim: Bashkia Himarë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëherëshme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara të DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative të pamatshme.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE:

C/I.Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë** që t’i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Bashkisë Himarë, **të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 9 punonjësit e mëposhtëm:**

a) “Largim nga Shërbimi civil”

1.z.G.S. me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,

2.z.E.M. me detyrë specialist i topografisë, në zyrën e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit periudha 2014-2016,

3. z.K.K. inspektor i taksave në Drejtorinë e Taksave në Bashkinë Himarë për periudhën 16 mujore vitit 2014 deri në muajin shkurt 2015, me urdhrin nr. 09, dt.16.02.2015 është emëruar Inspektor i Vlerësimit dhe kontrollit në teren viti 2015 dhe me urdhrin nr. 60, dt.29.02.2016, nga Përgjegjës i Taksa-Tarifave” është emëruar Përgjegjës i Zyrës së taksave familjare “ e në vazhdim për vitin 2017, për të metat e mangësitë e konstatuara sa vijon:

4. z.B.B.ish-Përgjegjëse e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Himare, periudha 12 mujore muaji shkurt 2014-shkurt 2015, larguar me urdhrin nr. 6, datë 16.02.2015 pasi është emëruar inspektore e ndihmës sociale (aktualisht Drejtore e Ndhimave ekonomike).

b)“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 4 punonjës:

1. **znj.M.K.** me detyrë Drejtore e Financë Buxhetit,
2. **z.O.V.** me detyrë specialist prokurimesh,
3. **z.S.K.** me detyrë specialist ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve,
4. **znj.E.R.** specialiste arkitekthe në zyrën e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit periudha 2014-2016.

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore;

a- “Zgjidhja e kontratës së punës”, neni 9 shkronja “c”, e kontratës individuale për 5 punonjësit si më poshtë:

1. **Th.L.** periudhën 24 mujore 2014-2016, respektivisht me detyrë “ Drejtor i Financës dhe Taksa e Tarifa” Bashkia Himarë për periudhën 2014 deri muaji Shkurt 2016, dhe periudhën 10 mujore Mars-Dhjetor 2016 me detyrë “Drejtor i të Ardhurave” emëruar me urdhrin nr. 25, datë 29.02.2016, për të cilën vazhdon edhe në vitin 2017

2. **z.Th.S.** ish- specialist i lartë i procedurës administrative,aktualisht Përgjegjës i zyrës juridike.

3. **z.I.Gj.** me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues,

4. **z.A.D.** me detyrë ish Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor për periudhën 01.07.2014 deri 01.03.2016, aktualisht me detyrë inspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor për periudhën 01.04.2016 deri 31.12.2016,

5. **z.E.Z.** me detyrë inspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor për periudhën 01.07.2014 deri 31.12.2016,

b. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, neni 9 shkronja “b”, të kontratës individuale, për 7 punonjësit si më poshtë:

1. **z.O.G.** me detyrë Përgjegjës i zyrës së sektorit të Pyjeve, kullotave emergjencave civile për gjithë periudhën objekt auditimi,

2. **z.R.H.** me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor për periudhën 01.04.2016 deri 31.12.2016,

3. **znj.B.R.** me detyrë specialiste e taksave në zyrën e Drejtorisë Ekonomike, për periudhën 01.07.2014-31.12.2016,

4. **z.I.D.**inspektor i tatim-taksave Bashkia Himarë, ish-Përgjegjës i tatim-taksave në ish-Komunën Lukovë për periudhën e vitit 2014-2015 deri në muajin maj 2016 dhe me urdhrin nr. 109, datë 26.05.2016 deri më datën 03.03.2017,

5. **znj.I.Ll.** “Inspektore e vlerësimit dhe kontrollit në teren”, respektivisht, me urdhrin nr. 12, datë 16.02.2015, është emëruar “Inspektore e vlerësimit dhe kontrollit në teren” dhe me urdhrin nr. 62, datë 29.02.2016, është emëruar kontabilist i shpenzimeve dhe të ardhurave.

6. **z. A.B.,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes,

7. **z.V.L.** me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës Juridike, aktualisht specialist i aseteve,

C/IV. NJOFTIM DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

C/V. Për punonjësit që nuk mund të rekomandojmë masë pasi mangësitë e konstatuara nuk përmbushin kushtet për masa disiplinore.

z.A.B.me detyrë administrator në njësinë administrative Lukovë,
z.I.Gj. me detyrë specialist i pyjeve dhe kullotave njësia administrative Lukovë,
z.J.B. me detyrë Drejtor i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, periudha 2014 dhe 2016,
Shënim: Në mënyrë më të hollësishme shkeljet për secilin person në Rubrikën C- Masa disiplinore, janë trajtuar në ANEKSIN Nr.A, bashkëlidhur këtij Projekt /Vendimi.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), 14 punonjësve si më poshtë:**

1. **K.K.** me detyrë inspektor i vlerësimit dhe i kontrollit në terren në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në 14 procedura prokurimi dhe në cilësinë e anëtarit të KVO në 1 procedurë prokurimi.
2. **Th S.** me detyrë përgjegjës i Zyrës Juridike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në 8 procedura prokurimi dhe në cilësinë e anëtarit të KVO në 3 procedura prokurimi.
3. **F.B.** me detyrë specialist i lartë ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në 2 procedura prokurimi dhe në cilësinë e anëtarit të KVO në 10 procedura prokurimi.
4. **I.LI.** me detyrë kontabiliste për të ardhurat e shpenzimet, në cilësinë e anëtarit të KVO në 6 procedura prokurimi në cilësinë e kryetarit të KVO në 1 tender

5.M.L. larguar nga puna, me detyrë ish përgjegjëse e financës.**në cilësinë e anëtarit** të NJHDT në 2 procedura prokurimi dhe në cilësinë e antares së KVO në 2 procedura prokurimi

6. E.R. me detyrë specialiste e nivelit të parë, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në 7 procedura prokurimi .

7. E.M. me detyrë specialist i topografisë, në cilësinë e kryetarit të KVO në 7 procedura prokurimi dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, në 1 tender.

8.A.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes, në cilësinë e anëtarit të KVO, në 6 procedura prokurimi , në cilësinë e Kryetarit të KVO, në 5 procedura prokurimi dhe në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në 1 tender.

9. S.K. me detyrë specialist ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve,**në cilësinë e anëtarit të KVO**, në 12 procedura prokurimi dhe në cilësinë e anëtarit të NJHDT në 2 procedura prokurimi 10. Blerta Rrapo, me detyrë Inspektore e rregjistrimit dhe procedurave në Drejtorinë e të ardhurave, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

11. O.V. me detyrë specialist prokurimesh, në cilësinë e Kryetarit të KVO në 1 tender.

12. O.G. me detyrë përgjegjëse i zyrës pyje kullota, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në 2 procedura prokurimi me objekt

13.A.Th. me detyrë specialist i lartë ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në 1 tender

14.G.S. me detyrë drejtori i planifikimit dhe zhvillimit territorit, në cilësinë e kryetarit të KVO, në 1 tender.

Shënim: Në mënyrë më të hollësishme shkeljet për secilin person në Rubrikën D- Masa Administrative, janë trajtuar në ANEKSIN Nr.B, bashkëlidhur këtij Projekt /Vendimi.

D. 2. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban (Masa administrative “Heqje Licence”)

I. Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në pikën të VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “ Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, i rekomandojmë Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë Zhvillim Urban, “**Heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim** (heqjen e Licencës profesionale), për një afat deri nga 2-3 vjet, si më poshtë:

1.R.S. nën cilësinë e mbikqyrësit të punimeve përfaqësuesit ligjor të firmës “██████████” Shpk, me numër licence

2.ET, nën cilësinë e mbikqyrësit të punimeve, përfaqësuesit ligjor të firmës “██████████” Shpk (BOE mbikëqyrës të punimeve me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve) me numër licenc

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e mangësive të theksuara gjatë zbatimit të kontratës për investime në objektin:

- “**Shëtitorja Buzë Detit Qeparo, Faza II**”, Bashkia Himarë, ku nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca **në volume pune të pakryera dhe përfitim më tepër në vlerën 10,920,000 lekë pa tvsh.**

Më konkretisht si më poshtë:

1. **“Shëtitörja Buzë Detit Qeparo, Faza II”**, Bashkia Himarë

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës është caktuar bashkimi i operatorëve ekonomik “InfraKonsult” shpk me përfaqësues ligjor z. R.S. dhe “██████████” shpk me përfaqësues ligjor z. E.T. Kontrata e mbikëqyrjes mungon në dosjen teknike të objektit.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca **në volume pune të pakryera dhe përfitim më tepër në vlerën 10,920,000 lekë pa tvsh, mangësi në dokumentacion si dhe problematikat si më poshtë:**

I. Mangësi në dokumentacion: Konstatohet se në dokumentacionin teknik mungojnë:

1. Raportet e testimit të për llaçin, pllakat e gurit dhe mermerit të përdorura në objekt;
2. Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve;
3. Kontrata me kolaudatorin e punimeve;
4. Certifikatat e cilësisë për materialet e përdorura në objekt
5. Mungojnë provat me ngarkesë lidhur me ndriçimin;
6. Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;
7. Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
8. Akti i kolaudimit të objektit;
9. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve.

II. Mangësitë në zbatimin e punimeve:

Konkretisht nga auditimi i kryer rezultoi se janë përfutuar nga sipërmarrësi “██████████” shpk më tepër në vlerë, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit 10,920,000 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

- Vlera 10,920,000 lekë pa tvsh si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave. Këto veprime janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve, nr. 65 prot., datë 25.08.2015 dhe amendamentit të kontratës nr. 2539/1 prot., datë 12.08.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë përfaqësuar nga kryetari z. J.G. dhe operatorit ekonomik “██████████” Shpk të përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. R.Z.

Nga mbikëqyrësi i punimeve, Ing. R.S. dhe Ark.Urb. E.T. është vepruar në kundërshtim me:

- ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7,
- udhëzimin e KM nr.3, datë 15.02.2001 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3
- Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II/3.
- udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm në dosjen teknike.
- kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Himarë ku përcaktohen Detyrimet e mbikëqyrësit.

E. KALLËZIM PENAL:

I. Bazuar në kualifikimin e nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në

kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, Kreu I, neni 1, pika 2, germa b, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për:

1. **Z. J.G.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Himarë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor
2. **Z. K.K.** me detyrë Inspektor i vlerësimit dhe i kontrollit në terren në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, në cilësinë e anëtarit të NJHDT
3. **Znj. B.RR.** me detyrë Inspektore e regjistrimit dhe procedurave në Drejtorinë e të ardhurave, në cilësinë e anëtarit të NJHDT
4. **Z. TH.S.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës Juridike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe anëtarit të KVO
5. **Znj. M.L.** me detyrë ish-Përgjegjëse e Financës, në cilësinë e anëtarit të NJHDT
6. **Z. F.B.** me detyrë Specialist i lartë ndërtimi, në cilësinë e anëtarit dhe Kryetarit të KVO.
7. **Z. E.M.** me detyrë Specialist i topografisë, në cilësinë e kryetarit të KVO dhe anëtarit të NJHDT
8. **Znj. I.LL.** me detyrë kontabiliste për të ardhurat e shpenzimet, në cilësinë e anëtarit të KVO
9. **Z. S.K.** me detyrë specialist ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO
10. **Z. O.V.**, me detyrë Specialist prokurimesh, në cilësinë e Kryetarit të KVO
11. **Z. A.B.** me detyrë Drejtor i dhe Mirëmbajtjes, në cilësinë e anëtarit të KVO

Në 9 procedura të prokurimit publik NJHDT ka vendosur kriteret diskriminuese apo kriteret të cilat nuk përkasin me vlerën apo rëndësinë e prokurimit, duke kufizuar pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik dhe ulur konkurrencën, si dhe KVO ka shpallur fitues *Operatoret Ekonomikë* të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta për kualifikim të miratuara në DST, duke kualifikuar operator në po të njëjta kushte me operatorët e skualifikuar, në shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike si dhe veprime me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në vlerën **341,2 milion lekë** dhe favorizim me pa të drejtë operatorët ekonomikë të cilët nuk garantojnë cilësinë e investimit të prokuruar, si dhe dëm ekonomik në shumën **21,9 milion lekë**, shkaktuar nga diferenca e vlerave të ofertave ekonomike, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Praktikat e përmendura i takojnë 9 objekteve të prokurimit:

- “Shëtitörja Qeparo Faza II”
- “Rrjeti i jashtëm i ujësjellësit me vetëderdhje i fshatit Palase dhe i komplekseve turistike”
- “Rehabilitim i qendrës së fshatit Borsh”
- “Rehabilitim urban i sheshit të Lukovës”
- “Shërbimi i pastrimit Himarë”
- “Shërbimi i pastrimit në Njësinë Administrative Lukovë”
- “Rikonstruktion i kanalit Ujitës Vranisht Terbac”
- “Ndërtimi i ujësjellësit Bolene”
- “Ura në rrugën Kondraçe – Qendër – Kallam - Lagja Gjilekë - Dhërmi”

II. Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe nuk ka administruar dokumentacion mbi realizimin e investimeve, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe marrjen në dorëzim të tyre, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të

Ndërtimit”, UKM nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, për:

Z. G.S. me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në cilësinë e personit për marrjen në dorëzim të dokumentacionit tekniko-ligjor të zbatimit të punimeve, pasi për **7 investimeve publike** të realizuara nga Bashkia Himarë, me vlerë investimi prej **96,9 milion lekë**, nuk ka vënë në dispozicion të KLSH-së asnjë dokumentacion për zbatimin e punimeve
Praktikat e përmendura i takojnë 7 objekteve:

- “Rehabilitimi i sheshit Kudhes”
- “Rrjeti jashtëm ujësjellësit me vetërrjedhje i fshatit Palasë”
- “Rikonstruksion i kanalit ujitës Vranisht-Terbac”
- “Rikonstruksion shkollë e mesme Hore – Vranisht”
- “Rikonstruksion i rrugës hundexhepe Bolene”
- “Punime lagja Rinaj dhe Ferrunaj”
- “Ndërtim rruge varreza Vranisht”

III. Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3; Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, Kreu I, pika 2 dhe 15; ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, Kreu I, neni 5; si dhe kontratën e sipërmarrjes për:

13. Z. R.S. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe

14. Z. E.T. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për investim jo në përputhje me kriteret e kontraktuara dhe dëmin ekonomik në vlerën prej **10.9 milion lekë**, për shkak të punime të pakryera por të situacionuara dhe paguara, dhe mangësi të theksuara në dokumentacion tekniko-ligjor (dokumente fiktive dhe që nuk pasqyrojnë realitetin), për investimin “*Shëtitorja Buzë Detit Qeparo, Faza II*”.

G. INDICIE PËR NDJEKJE PENAL:

I. Në zbatim të nenit 15 germa “gj.; të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 248 dhe 181/a të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodit Procedurës Penale”, i ndryshuar, dërgojmë Indicie për Ndjekje Penale, për veprime në kundërshtim me nenin 131 dhe 181 të ndryshuar të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, për:

1.TH.L. periudhën 24 mujore 2014-2016, respektivisht me detyrë “Drejtor i Financës dhe Taksa e Tarifa” Bashkia Himarë për periudhën 2014 deri muaji Shkurt 2016, dhe periudhën 10 mujore Mars-Dhjetor 2016 me detyrë “Drejtor i të Ardhurave”.

2.TH.S. ish-Specialit i lartë i procedurës administrative, aktualisht Përgjegjës i zyrës juridike, për shkëlqet e mëposhtme:

-Për mos kërkimin ndaj 300 subjekteve të vlerës së taksës në shumën prej 32.631,848 lekë ose në masën 25% të detyrimeve gjithsej, duke sjellë për pasojë mos grumbullimin në arkën e Bashkisë Himarë të detyrimeve nga taksat e bizneseve.

-Nuk kanë nxjerre njoftim vlerësimet tatimore dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, veprim dhe mosveprim në kundërshtim me nenin 23/2 të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008.

-Moskryerje të detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë që janë ngarkuar me këto detyra, në kundërshtim me nenin 70/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe konkretisht:

Nuk u janë dërguar bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Nuk i janë dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre nuk janë llogaritur kamat vonesat, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë (gjohë), bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Nuk janë marë masa administrative apo sekuestro dhe pas marjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008”, ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 04.12.2014.

nuk kanë evidentuar dhe nuk ka njoftuar nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

Nga rreth 468 subjekte që ushtrojnë aktivitetin më datën 31.12.2016 vetëm për gjysmën e tyre ose 230 prej tyre janë hapur dosje por edhe këto jo të plota, në kundërshtim me nenin 29 të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008.

-Mos zbatimin e urdhrave të kryetarit të Bashkisë për fillimin e procedurave në lidhje me zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën e KLSH nr.770/20 datë 30.01.2015, me pasojë mos arkëtimin e detyrimeve, në vlerën **80,145,955 lekë**.

Për mos zbatimin e Planveprimit nr. 284 datë 20.02.2015 të miratuar nga kryetari i, në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH për periudhën e audituar nga data 01.01.2012 deri më datën 30.06.2014, të urdhrave të titullarit të bashkisë për subjektet debitorë ndaj njësisë vendore të cilat kanë krijuar dëm ekonomik apo të ardhura munguara, të cilëve nuk u është dërguar shkresë Bankave për bllokimin e llogarive, duke respektuar nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”, nuk janë vendosur gjoha në masën 25% të detyrimit dhe nuk është kërkuar kallëzim penal sipas nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe nenit 181, të Kodit Penal.

Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R